

Ekspozitë me fotografi dhe dokumente
Kujtesa e Kosovës: Demonstratat shqiptare '68

Kjo ekspozitë, e hapur sot, më 23 nëntor 2018, me ndihmën e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, u kushtohet Demonstratave të vitit 1968 në 9 qytete të Rrafshit të Dukagjinit, të Rrafshit të Kosovës, të Llapit, të Anamoravës dhe të Luginës së Pollogut. Studentët, rinia dhe populli shqiptar dolën me vendosmëri në rrugë kundër shtypjes e robërisë dhe me guxim të madh i shtruan kërkesat: Kushtetutë, Republikë dhe Vetëvendosje për Kosovën dhe për viset e tjera shqiptare nën pushtimin jugosllav, 24 vjet pas Luftës së Dytë Botërore. Pushteti jugosllav i dënoi këto demonstrata, ndërhyri me polici, rrugët u përgjakën, burgjet u mbushën, por lufta politike nuk u ndal deri në fitoren e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, më 1999.

Të dhënat kryesore për ekspozitën

- Pamje të Demonstratave të vitit 1968 në Prishtinë, më 27 nëntor 1968.
- Pamje të organizatorëve të Demonstratave të vitit 1968, tetor - dhjetor, nga 9 qytete: Prizren, Therandë, Pejë, Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjilan, Besianë, Tetovë.
- Pamje e disa flamujve të ngritur në Demonstratat e vitit 1968.
- Pamje nga ngritja e flamurit kombëtar në Plavë e Guci.
- Dokumente të dënimeve të gjykatave për organizuesit dhe për pjesëmarrësit e Demonstratave të vitit 1968, tetor - dhjetor, nga 9 qytete: Prizren, Therandë, Pejë, Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjilan, Besianë, Tetovë.
- Pamje nga shënimi i 40-vjetorit të Demonstratave të vitit 1968: Prizren, Therandë, Pejë, Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjilan, Besianë, Tetovë.
- Pamje të tjera lidhur me Demonstratat e vitit 1968.

Ekspozita është përgatitur me përkushtim të madh nga Meriman Braha dhe Ismail Ismaili, më 2008, por tash këtu janë shtuar edhe fotografi të vitit 2008, me rastin e shënimit të dyzetvjetorit, si dhe të viteve të tjera të Lëvizjes Kombëtare. Ajo është pjesë e programit për shënimin e 50-vjetorit të Demonstratave të vitit 1968, i hartuar nga Këshilli Organizues, i përbërë nga Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, Instituti i Historisë, Prishtinë, Instituti Albanologjik, Prishtinë.

Prof. dr. Zymer Neziri